



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:192078
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05444725

Ac.nr.8077/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Arsim Hamzaj- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve A. K., N. S., B. H., Sh. Sh. dhe R. M., te cilët i përfaqëson sipas autorizimit B. P., avokat ne Vushtrri, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) – Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit, kompensim i pagës se trembëdhjetë, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, me vlerë të objektit të kontestit në shumë prej 25,049.76 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.7027/21, të datës 01.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më **13.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PA BAZUAR, ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme me seli në Prishtinë, parashtruar përmes përfaqësueses nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.7027/21, i datës 01.08.2023, në pikën **I** dhe **II** të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

II. Pika **III** e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.7027/21, i datës 01.08.2023, **mbetet e pa shqyrtuar**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.7027/21 të datës 01.08.2023, me aktgjykimin për shkak të pa dëgjueshmërisë, jashtë seancës, ka vendosur si në vijim:

APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve A. K., N. S., B. H., Sh.Sh. dhe R. M., ashtu që DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Polica e Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësve t’iu paguaj shumat si më poshtë:

- Paditësit A. K., në emër të shpërblimit për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page të rregullt mujore për secilin fund vit t’ia paguaj shumën nga 531.9 euro, e në total për katër vite shumën prej 2,127.6 euro.

- Paditësit N. S., në emër të shpërblimit për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page të rregullt mujore për secilin fund vit t’ia paguaj shumën nga 648€, e në total për katër vite shumën 2,592 euro, ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në pune, në vlerë prej 25% të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 174.07 euro, apo shumën e përgjithshme prej 2,766.07 euro

- Paditësit B. H., në emër të shpërblimit për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page të rregullt mujore për secilin fund vit t’ia paguaj shumën nga 624.69 euro, e në total për katër vite shumën prej 2,498.76 euro, ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në pune, në vlerë prej 25% të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 174.07 euro, apo shumën e përgjithshme prej 2,672.83 euro

- Paditësit Sh. Sh., në emër të shpërblimit për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page të rregullt mujore për secilin fund vit t’ia paguaj shumën nga 621,13 euro, e në total për katër vite shumën prej 2,484.52 euro, ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në pune, në vlerë prej 25% të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 174.07 euro, apo shumën e përgjithshme prej 2,658.59 euro

- Paditësit R. M., në emër të shpërblimit për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në vlerë të një page të rregullt mujore për secilin fund vit t’ia paguaj shumën nga 663.99 euro, e në total për katër vite shumën prej 2655.96 euro, ndërsa në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në pune, në vlerë prej 25% të një page mesatare të vitit 2020, shumën prej 174.07 euro, apo shumën e përgjithshme prej 2,830.03 euro.

II. DETYROHET i padituri që paditëses shumën e gjykuar si në pikën -I- të këtij dispozitivi, t’ia paguaj me kamatë ligjore në lartësi prej 8% në vit, nga data e parashtrimit të padisë, 25.08.2021, e gjer në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, në lartësi prej 724 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me detyrim.

III. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve N. S., B. ., Sh. Sh. dhe R.M., për pagesë të shpërblimit jubilar, përtej shumave të aprovuara si në pikën -I- të këtij dispozitivi, për secilin veç e veç shumën prej 110.93 euro, si dhe paditësit A. K. shumën prej 142 euro dhe në emër të pagesës së pagave të fund vitit, shumën prej 308.92 euro, si dhe refuzohet në tërësi kërkesa e paditësve për pagesë të shujtave ditore për periudhën kohore nga data 14.11.2018 deri më 23.02.2022, për 740 ditë pune, në shumë prej 2,220 euro, për secilin paditës, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës në shumë prej 1,873 euro, SI E PA BAZUAR.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe duke marrë për bazë interesin juridik të parashtruesit të ankesës, konsiderohet se i njëjti aktgjykimin e ankimuar e ka goditur pjesërisht dhe atë vetëm sa i përket pikës **I** të dispozitivit (pjesës aprovuese të kërkesëpadisë), si dhe pikës **II** (vendosjes për shpenzimet e procedurës dhe kamatë vonesën), me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, apo të njëjtin ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pa bazuar.

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, brenda afatit ligjor, kanë ushtuar përgjegjje në ankesë duke i refuzuar në tërë pretendimet ankimore të të paditurës me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 par.1, pika d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, parashtruar përmes përfaqësueses nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit, A. K., N. S., B. H., Sh. Sh. dhe R. M., përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim B.P., avokat nga Vushtrria, me datë 25.08.2021 ka ushtuar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, për fund vitet 2018,2019, 2020 dhe 2021, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, në lartësinë e kërkuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura, brenda afatit ligjor, përmes përfaqësueses nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore në Prishtinë, ka parashtruar përgjigje në padinë me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetim se e njëjta është e palejuar sepse paditësit nuk i kanë shterur mjetet e brendshme të ankimit, ashtu siç parashihet me nenin 78 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 79 i Ligjit Nr.03/L-212 të punës. Tutje ka theksuar se e kundërshton edhe kërkesëpadinë e paditësve për sa u përket kompensimit të pagës së trembëdhjetë, pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe atë lidhur me nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Më tej ka theksuar se pagesat për shujta ditore janë realizuar varësisht prej

mjeteve buxhetore të aprovuara dhe atë vetëm për një pjesë të zyrtareve policor të cilët janë të angazhuar në raste të veçanta. Ka shtuar se Udhëzimi Administrativ i të paditurës ku është mbështetur kërkesëpadia e paditësve nuk ka veprim retroaktiv, si dhe nuk është në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, sipas saj Policia e Kosovës, nuk mund të vendos për ndarjet buxhetore me anë të Udhëzimit Administrativ, por ato përcaktohen me anë të ligjit që i nënshtrohen miratimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Si i tillë, UA nr.02/2018 sa i përket implikimeve financiare nuk ka fuqi të prodhoj efekte financiare të cilat nuk janë paraparë me Ligjin mbi Ndarjen e Buxhetit, dhe mbi bazën e kësaj nuk mund të ketë përparësi një udhëzim administrativ ndaj ligjit. Me propozim për Gjykatën që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të përgjigjes në padi, shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 150 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë, ashtu që ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë si të themeltë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ka theksuar se gjykata bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës – flet dërgesën për dorëzim personal, ka vërtetuar faktin se e paditura me datë 23.03.2023, e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi C.nr.7027/2021, padinë dhe provat e bashkangjitura padisë, mirëpo e njëjta deri në datën e marrjes së këtij aktgjykimi nuk ka dhënë përgjigje në padi.

Me dispozitën ligjore nga neni 150, paragrafi 1, të ligjit të lartcekur është përcaktuar se “në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimin për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.”

Gjykata, lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, vlerëson se janë plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e përcaktuara me nenin 150, paragrafi 1, pika, b dhe e, të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118, për marrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë. Kjo sepse gjykata palës së paditurit i ka dorëzuar padinë me provat e bashkangjitura si dhe aktvendimin për përgjigje në padi, me paralajmërimin lidhur me pasojat ligjore në rast të mos dhënies së përgjigjes në padi brenda afatit të përcaktuar, e njëjta nuk ka dhënë përgjigje në padi në afatin e përcaktuar, ndërsa themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi, të cilat provohen me provat materiale të bashkangjitura në padi, në bazë të të cilave është provuar baza dhe lartësia e kërkesëpadisë.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se në këtë çështje juridike

kontestimore kërkesëpatria e paditëseve është pjesërisht e bazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë nga formulari i vlerësimit të performancës vërtetohet fakti se paditësi A. K., nga data 17.01.2005, është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës 04/1-04-SRR-A/581/2021, i datës 26.04.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 531.90 euro, paditësi N. S., nga data 24.04.2000, është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vendimi me numër të referencës 05/1-03/SR293/2021, i datës 10.06.2021 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 648 euro, paditësi B. H., nga data 23.10.2000, është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vërtetimi me numër të referencës 05/1-03/SR297/2021, i datës 11.06.2021 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 624.69€, paditësi Sh. Sh., nga data 20.11.2000, është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vërtetimi me numër të referencës 05/1-03/SR295/2021, i datës 10.06.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 621.13 euro si dhe paditësi R. M., nga data 27.03.2000, është në marrëdhënie pune tek e paditura ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës, ndërsa nga vërtetimi me numër të referencës DDK-05/611/2021, i datës 27.05.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi nga marrëdhënia e punës tek e paditura realizon pagë mujore në lartësi prej 663.99€. Ashtu që katër paga për fund vit për secilin paditës arrin shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, provave të lartcekura, me të cilat vërtetohen faktet lidhur me marrëdhënien e punës të paditësve tek e paditura, vlerësimet e performancës së punës dhe lartësinë e pagave të paditësve, ua fali besimin e plotë dhe të njëjtat i pranoi si prova materiale, në kuptim të nenit 329, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuar nga vet e paditura.

Bazuar në nenin 2, paragrafi 2, të LPK-së, ku është përcaktuar se “Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas vlerësimit të saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”, gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076, për Policinë, Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 dhe Udhëzimit Administrativ nr.01/2021, mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Me nenin 44, paragrafi 2, të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, është përcaktuar se “marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”.

Me Udhëzimin Administrativ nr.02/2018, në nenin 29, paragrafi 1, 2 dhe 5, si dhe me Udhëzimin Administrativ nr.01/2021, në nenin 30, paragrafi 1, 2 dhe 5, është përcaktuar se “Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në

përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici. Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”.

Gjykata, bazuar në dispozitat sipër cekura dhe gjendjes faktike të provuara si më lartë, aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, duke e detyruar të paditurën që paditësve në emër të shpërblimit të fund vitit – pagës së 13, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 t’ua paguaj shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Kjo sepse nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka provuar faktin se paditësit, kanë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara me nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 dhe nenit 30, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ 01/2021, për pagesën e shpërblimit të fund vitit – pagës së 13, nga se të njëjtit kanë pasur rezultatet në punë të vlerësuara në nivelin e përcaktuar me dispozitën në fjalë dhe ndaj tyre, për periudhën kohore në fjalë, nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata ka aprovuar kërkesën e paditësve për pagesë të shpërblimit jubilar, në shumën si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 29, respektivisht 30, të udhëzimeve administrative numër 02/2018 dhe 01/2021, pasi që nga vlerësimet e performancës është vërtetuar fakti se paditësit N. S., B.H., Sh. Sh. dhe R. M., janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe 10 vite të përvojës së punës i kanë arritur në vitin 2020.

Lartësia e shpërblimit jubilar e aprovuar i referohet të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të datës 15.06.2022, nga e cila rezulton se paga mesatare në Policinë e Kosovës për vitin 2020 ka qenë 696.30€. Ashtu që shumat e aprovuara paraqesin vlerën prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës të vitit përkatës në të cilin është arritur viti jubilar nga paditësit.

Gjykata vendosi si në pikën –III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me refuzimin në tërësi të kompensimit të shpërblimit jubilar për paditësin A. K., për faktin se i njëjti është punësuar tek e paditura në vitin 2005 dhe 10 vite të përvojës në punë (jubileun) e ka arritur në vitin 2015, ndërkaq jubileun e ardhshëm e arrin në dhjetor të vitit 2025, e që në rastin konkret nuk mund të zbatohen Udhëzimet Administrative 02/2018 dhe 01/2021, për faktin se këto udhëzime nuk kanë efekt dhe nuk krijojnë të drejta dhe detyrime për asnjë kërkesë e cila ka lindur para se këto udhëzime të kenë hyrë në fuqi, ndërsa për paditësit N.S., B. H., Sh. Sh. dhe R. M., vendosi duke u bazuar në dispozitën nga nenin 29 respektivisht neni 30 të udhëzimeve administrative 02/2018 dhe 01/2021, ku është përcaktuar se “Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”. Nga këto udhëzime administrative, rezulton se të punësuarve në Policinë e Kosovës, për dhjetë vite të punës u takon e drejta në pagesë të shpërblimit jubilar, në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës, dhe jo ashtu siç kanë pretenduar paditësit në lartësi prej 50% të një page bazë.

Gjykata po ashtu vendosi si në pikën –III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me pagesën për pagat e fund vitit për paditësin A. K., sepse i njëjti sipas vendimit me numër të referencës 04/1-04-SRR-A/581/2021, i datës 26.04.2021, ka pagën në lartësi prej 531.9 euro, e jo sa ka pretenduar paditësi në shumë prej 609.13 euro.

Gjykata refuzoi edhe kërkesën për kompensimin e ushqimit (shujtave ditore), pasi që në vlerësimin e saj paragrafi 1 i nenit 29 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 dhe paragrafi 1 i nenit 30 të Udhëzimit Administrativ 01/2021, nuk kanë karakter detyrues dhe si të tilla nuk e obligojnë të paditurën për pagesë të shujtave ditore të pretenduara nga paditësit si në padi.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, ku është paraparë se Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën, lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit. Ndërsa si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën e ushtrimit të padisë në gjykatë datë 25.08.2021.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditësve për padi 624 euro dhe për taksë gjyqësore për padi 100€, (sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, për pesë paditës)

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pikat e atakuara me ankesë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as në shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuuese, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë,.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadiisë së paditësve, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërthënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të të paditurit se gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadiisë së paditësve, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare marrëdhënie e punës e paditësit tek e paditura, vlerësimi pozitiv i performacës për paditësit nga e paditura për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 dhe mungesa e shqiptimit të ndonjë masë në procedurë disiplinore për paditësit e po ashtu edhe lartësia e pagave. E paditura nuk ka arritur të provojë se i ka kompensuar paditësit pagat e kërkuara.

Gjykata e Apelit, analizoi dhe vlerësoi me kujdes pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së Aktgjykimit ankimor ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si pasojë e shkeljeve procedurale të nenit 398 të LPK-së për faktin se nuk ka hapur fare shqyrtim lidhur me prapësimin e të paditurës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të atakuar gjeti një pretendim i tillë është i pabazuar.

Nga interpretimi i nenit 150 të LPK-së del se në qoftë se, në qoftë se palës së paditur i është dorëzuar aktvendimi për përgjigje në padi së bashku me padinë dhe shkresat e lëndës dhe e njëjta brenda afatit ligjor nuk ka ushtruar përgjigje në padi siç rezulton nga shkresat e lëndës, dhe nga provat e shqyrtuara nga gjykata del themelësia e pjesërishme e kërkesëpadiisë së paditësve, atëherë, rezulton se gjykatat do të duhej që të jepnin aktgjykimin pa procedim të mëtejme, sa herë që plotësohen kushtet e parapara me këtë dispozitë. Në këtë rast aktgjykimi ankimor nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenit 182 paragrafi 2 pika n) për faktin se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar i ka dhënë arsyet lidhur me prapësimin e të paditurës për parashkrimin e kërkesës në këtë çështje kontestimore të cilat arsye Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i pranon si të drejta dhe ligjore.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se kërkesëpadiia e paditësve duhet të hudhet si e palejuar për shkak se nuk i kanë shtjerr mundësitë e ankesës brenda institucionit të të paditurës në kuptim të nenit 78 dhe nenit 79 të Ligjit të Punës. Gjykata e Apelit thekson se e drejta e punës është kategori kushtetuese e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, dhe në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (*kërkesat materiale*) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, (sepse në rastin konkret nuk bëhet fjalë për procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës ku aplikohet neni 78, neni 79 dhe neni 82 i Ligjit të Punës) e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësit në asnjë rrethanë nuk mund ti mohohet e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pa bazuara pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë thekson se kompensimin e pagës së 13-të do ta bën vetën në bazë të mundësive buxhetore të punëdhënësit ngase asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim ligjor, se me qëllim të sigurimit të mjeteve buxhetore për realizimin e kësaj pagese, Policia e Kosovës me datë 24.10.2017 përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme ka parashtruar kërkesë buxhetore sipas Qarkores Ref 2018/02 për periudhën 2018-2020 që të ndahet një shumë e caktuar e mjeteve për mbulimin e kërkesave të tilla, kërkesa e Policisë së Kosovës nuk është aprovuar nga ana e autoritetit miratues- Ministrisë së Financave. Këto pretendime e paditura nuk i ka mbështetur me asnjë provë konfirmimit 7 lidhur me nenin 319 të LPK-së ku parashihet se “*secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*” , për më tepër çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e Udhëzimit Administrativ 02/2018, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpapia të trajtohet si e pa themeltë.

Nuk qëndron pretendimi ankimor në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale pasi që me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës dhe atë me nenin 29 paragrafi 1 tek e drejta në pagë dhe e shpërblimit, përcaktohet se “*Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici*”, ndërsa me të njëjtin, nen paragrafi 2 përcaktohet se “*Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit*”.

Paditësit i plotësojnë kushtet për të përfituar një kompensim të tillë, pasi që janë në marrëdhënie pune të e paditura, nuk kanë pasur masë disiplinore të shqiptuar për vitet kontestueses, 2018,2019, 2020 dhe 2021, ndërsa kanë pasur vlerësim të mirë për këto vite, lartësia e pagës është përcaktuar në bazë të listës së pagave për vitet, 2018,2019, 2020 dhe 2021 si dokument publik lëshuar nga e paditura.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t’i shmanget detyrimit për përmbushje.

Sipas Gjykatës së Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personelit të policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës bazuar në udhëzimin Administrativ numër 02/2018 i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018 si dhe Udhëzimi Administrativ 01/2021 i cili ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2021 i cili e ka shfyqizuar Udhëzimi Administrativ nr.02/2018, mirëpo sipas kësaj gjykate,

personeli i policisë kanë të drejtë që edhe për vitin 2021, të përfitojnë shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse plotësohen kushtet e theksuara si më lartë, për arsye se neni 29 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, ka qenë në fuqi deri më datën 29.09.2021, dhe ka qenë i katakterit detyrues, sipas të cilit punëdhënësi ka qenë i obliguar që edhe për vitin 2021, të planifikojë mjetet buxhetore, ndërsa është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 213/2023 e datës 09.10.2023, ku përcaktohet e drejta e personelit të policisë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë me plotësimin e kushteve ligjore si më lartë.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të LMD-së, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore, nga data e ushtrimit të padisë e gjer në përmbushjen definitive të detyrimit.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqë, aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur me ankesë në pikën **III** të dispozitivit të tij nga pala me interes juridik, gjykata e shkallës së dytë, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor të mjetit juridik (kufinj të ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar), sipas nenit 194 të LPK-së, si dhe Institutit “Reformatio in Peius” nga neni 203 i LPK-së, këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8077/23, datë 13.03.2024

Numri i lëndës: 2021:192078
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05444725

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka**